



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS

Profili i lehtë i migrimit

2018

AUTORITETI QEVERTAR PËR MIGRIM

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe i takojnë Autoritetit Qeveritar për Migrim - Qeveria e Republikës së Kosovës. Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Në rast të përdorimit të të dhënave nga ky dokument, duhet cituar burimin.

MOHIM

Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga Qeveria Gjermane dhe zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-it.

Kontakti:

Autoriteti Qeveritar për Migrim
Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme
Tel: + 381 (0) 38 200 19 545
www.mpb.rks-gov.net
*Adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" 13.
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës*

Qëllimi i Profilit të Lehtë të Migrimit 2018

Profili i Lehtë i Migrimit për vitin 2018 për Republikën e Kosovës, është hartuar në përputhje me strukturën dhe metodologjitë ndërkombëtare për hartimin e profileve të lehta të migrimit, si dhe iu është përshtatur rrethanave dhe trendeve migruese në Kosovë. Në këtë dokument janë prezantuar trendet dhe politikat e Kosovës që ndërlidhen me migrimin, përfshirë imigrimin dhe emigrimin. Dokumenti, gjithashtu përmban analiza të trendeve dhe lëvizjeve migruese në Republikën e Kosovës. Dokumenti si i tillë, reflekton ndryshimet në politika, legjislacion apo zhvillimet institucionale që kanë ndodhur gjatë vitit 2018, përderisa në seksionet e dokumentit ku nuk ka pasur zhvillime apo ndryshime, artikulli i tekstit ka mbetur i ngjajshëm me profilet e viteve paraqara.

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një pasqyrë të zhvillimeve në fushën e migrimit për institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin akademik/studiuës. Dokumenti përmban rekomandime të cilat mund t'iu shërbejnë vendimmarrësve, me qëllim të përfshirjes së këtyre rekomandimeve në politika shtetërore dhe sektoriale që ndërlidhen me çështjet e migrimit dhe të zhvillimit të vendit.

Në analizën e trendeve të migrimit të prezantuar në këtë dokument, mbulohet periudha 3-vjeçare nga viti 2016 deri në vitin 2018, e paraqitur përmes figurave dhe tabelave, ku përfshihen potencialisht edhe periudhat paraqara të ndonjë ndryshimi të dukshëm të trendeve migruese.

Struktura e dokumentit përfshin zhvillimet e politikave dhe legjislacionit, zhvillimet institucionale, si dhe analizën e të dhënave statistikore që ndërlidhen me fushën e migrimit.

Dokumenti i Profilit të Lehtë të Migrimit 2018 është hartuar nga ekspertët e institucioneve të Republikës së Kosovës, të cilët njëherësh janë anëtarë të Autoritetit Qeveritar për Migrim, me përkrahje teknike dhe ekspertizë nga partnerët ndërkombëtarë.

Përmbajtja

Qëllimi i Profilit të Lehtë të Migrimit 2018	2
1. Informatat e përgjithshme për shtetin.....	6
1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve.....	6
1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin	7
2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e migrimit.....	9
2.1. Rrjedhat e migrimit	9
2.2. Stoqet e migrimit	11
3. Migrimi i rregullt me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore.....	13
3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse	13
3.2. Politikat dhe Korniza Ligjore.....	13
3.3. Statistikat	15
4. Migrimi i parregullt	19
4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse	19
4.2. Politikat dhe Korniza Ligjore.....	19
4.3. Statistikat	20
5. Kthimi, ripranimi dhe riintegrimi	27
5.1. Kthimi i të huajve	27
5.1.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	27
5.1.2. Politikat dhe Korniza Ligjore	27
5.1.3. Statistikat.....	28
5.2. Ripranimi.....	30
5.2.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	30

5.2.2.	Politikat dhe Korniza Ligjore	30
5.3.	Riintegrimi.....	32
5.3.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	32
5.3.2.	Politikat dhe Korniza Ligjore	32
5.3.3.	Statistikat.....	33
6.	Integrimi.....	36
6.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse	36
6.2.	Politikat dhe Korniza Ligjore.....	36
6.3.	Statistikat	37
7.	Migrimi dhe Zhvillimi.....	39
7.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse	39
7.2.	Politikat dhe Korniza Ligjore.....	40
7.3.	Statistikat	43
8.	Azili dhe mbrojtja ndërkombëtare.....	46
8.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse	46
8.2.	Politikat dhe Korniza Ligjore.....	46
8.3.	Statistikat	47
9.	Konkludimet dhe rekomandimet	51

Shkurtesat

Shkurtesa	Përshkrimi
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi European
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DHTQNJ	Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore
DIMAK	Qendra Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DRPR	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
EUROSTAT	Agjencia Europiane e Statistikave
FRONTEX	Agjencia Europiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
ILECU	Njësia për Koordinim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MDIS	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
APRK	Agjensioni i Punësimit të Republikës së Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
RAE	Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UA	Udhëzimi Administrativ

1. Informatat e përgjithshme për shtetin

1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve

Republika e Kosovës është shteteti më i ri në Gadishullin Ballkanik me një pozicion gjeografik qendror e rrethuar me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë.



Rajoni: Europa Juglindore

Gjerësia e territorit të Kosovës: 41° 51' 21 dhe 43° 16'

Gjatësia e territorit të Kosovës: 19° 59' dhe 21° 47'

Emri zyrtar: Republika e Kosovës

Kryeqyteti: Prishtina

Gjatësia e kufijve: Me Republikën e Shqipërisë në jugperëndim 113.551 km, me Republikën e Maqedonisë në jug 170.772 km, me Republikën e Malit të Zi në veriperëndim 79.165 km, me Republikën e Serbisë në verilindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror, kurse **gjatësia e përgjithshme e kufirit është** 743.556 km¹.

Sipërfaqja: 10,908 km²

Vendet fqinje: Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë.

Popullsia: 1,795,666 (e vlerësuar me 1 Janar 2019).

Dendësia e popullsisë: 164 banorë për 1 km²

Forma e qeverisjes: Republikë Parlamentare

Valuta: Euro (EUR)

Dita e pavarësisë: 17 shkurt 2008

Presidenti: z. Hashim Thaçi

¹ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/ALB_Strategjia_Kombetare_MIK_2013-2018_12.07.2013.pdf

² Po aty

1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin

Republika e Kosovës është shtet i së drejtës me demokraci parlamentare i bazuar mbi parimin e ndarjes së pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore. Shtylla e tretë është pushteti gjyqësor, i cili është i pavarur, unik dhe ushtrohet nga gjykatat. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.

Kompetencat administrative në fushën e migrimit dhe azilit, ndërthuren në mes të nivelit qendror dhe atij lokal (komunal).

Sistemi për menaxhimin e migrimit në Kosovë është i rregulluar përmes kornizës ligjore³ dhe asaj institucionale. Ministria e Punëve të Brendshme është institucion përgjegjës i cili adreson çështjet e azilit, të huajve, shtetësisë, ripranimit, migrimit të parregullt, si dhe çështjet e riintegritimit të personave të riatdhesuar. Institucionet e tjera që kanë përgjegjësi në çështjet e migrimit janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit European, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Policia e Kosovës si dhe Banka Qendrore e Kosovës.

Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM), i themeluar me Vendim⁴ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është përgjegjës për monitorimin e lëvizjeve migruese dhe funksionon si

³ Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt, Ligji nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligji Nr.06/L-026 për Azil, Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Ligji Nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.06/L-013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligji Nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji Nr.03/L-208 për Ripranim, Ligji Nr.04/L-076 për Policinë, Ligji Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Ligji Nr.04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, Rregullorja (QRK) Nr. 13/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Punësimit.

⁴ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 08/158, i datës 29 nëntor 2013 për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit.

mekanizmëm ndërinstytucional duke përfshirë të gjithë akterët relevantë në fushën e migrimit. AQM-ja është përgjegjëse për hartimin e profileve të migrimit dhe u jep rekomandime autoriteteve shtetërore në fushën e migrimit.

2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e migrimit


Numri i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2018 (1 janar 2019) është vlerësuar të jetë 1,795,666 banorë. Agjencia e Statistikave të Kosovës çdo vit bën vlerësimin e numrit të popullsisë, duke përfshirë të dhënat për migrimin, me përdorimin e metodologjisë së standardizuar me qëllim të gjithëpërfshirjes së të gjitha grupeve të migrimit.

2.1. Rrjedhat e migrimit

Imigrimi

Numri i përgjithshëm i imigrimit gjatë vitit 2018, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ishte gjithsej 6,762 persona^[1] apo 0.37% e gjithë popullsisë rezidente. Në këtë shifër janë përfshirë të gjithë imigrantët (Kosovarë dhe jo Kosovarë) pa marrë parasysh arsyen e imigrimit.

Figura 1: Trendi i imigrimit në Kosovë për vitet 2016-2018



Burimi: ASK


Për periudhën 2016-2018, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që kanë imigruar (të huaj me leje-qëndrime të përkohshme, të kthyer) me një mesatare vjetore prej 11,556 personave apo 0.64% e popullsisë brenda një viti.

[1] Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2018, faqe 10 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2019: <http://ask.rks-gov.net/media/3385/vleresimi-i-popullise-se-kosoves-2018.pdf>

Emigrimi

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2018, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 28,164 persona^[2] apo 1.5% e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (rregullt & parregullt).

Figura 2: Emigrimi kosovar i vlerësuar nga ASK-ja, 2016-2018



Burimi: ASK

Të dhënat për periudhën 2016-2018 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare vjetore prej 20, 479 personave apo 1.14% të popullatës kosovare.

Migrimi neto

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2018 ishte -21,402 banorë apo -1.2% e popullsisë rezidente. Për periudhën 2016-2018 vlerësohet se Kosova ka humbur 35,773 banorë apo rreth 2% të popullsisë së vendit.

Tabela 1: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet 2016-2018

Vitet	Imigrimi	Emigrimi	Net migrimi (nr. absolut)	Net migrimi (përqindje)
2016	13,072	22,012	-8,940	-0.50
2017	5,832	11,263	-5,431	-0.30
2018	6,762	28,164	-21,402	-1.19

Burimi: ASK^[3]

^[3] Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2018, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2019: <http://ask.rks.gov.net/media/3385/vleresimi-i-popullise-se-kosoves-2016.pdf>

2.2. Stoqet e migrimit

Si pikë bazë (stok) për rrjedhën e migrimit, janë marrë të dhënat zyrtare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Sipas publikimit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të vitit 2014 me titull: "Migrimi Kosovar"^[4], duke u bazuar në të dhënat e vitit 2011 (1 prill), vlerësohet se janë më shumë se 550,000 banorë kosovarë që kishin emigruar nga Kosova prej vitit 1969, derisa popullsia e vlerësuar me prejardhje kosovare, duke përfshirë personat e lindur jashtë Kosovës, është vlerësuar të jetë 703,978 banorë deri më 1 prill 2011.

Stoqet e imigrimit

Llogaritet se mbi 2% e popullsisë apo mbi 35,773 banorë të Kosovës, së paku një herë a më shumë kanë qëndruar jashtë vendit për një periudhë të caktuar kohore (zakonisht më shumë se një vit), gjatë periudhës kohore prej vitit 1969 deri më 1 prill 2011. Pjesa më e madhe e imigrimit ka ndodhur në vitin 1999-2000, kur një numër i madh i kosovarëve janë kthyer në mënyrë vullnetare për të jetuar në Kosovë si rezultat e çlirimit të vendit. Po ashtu, edhe vitet 2016, 2017 dhe 2018 karakterizohen me më së shumti imigrantë kosovarë, si pasojë e kthimit të kosovarëve pas emigrimit të madh që kishte ndodhur në vitin 2014 dhe 2015.

Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedha e imigrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2016-2018

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i imigrimit (numra absolutë)	Stoku (përqindje)
2016	1,783,531	48,078	2.70
2017	1,798,506	53,910	3.00
2018	1,795,666	60,672	3.38

Burimi: ASK

Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2013-2018

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i emigrimit (numra absolutë)	Stoku (përqindje)
2016	1,783,531	170,743	9.57
2017	1,798,506	182,006	10.12
2018	1,795,666	210,170	11.70

Burimi: ASK

^[4] **MIGRIMI KOSOVAR**, Prishtinë, prill, 2014, faqe 76: <http://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

Stoqet e emigrimit: Në periudhën 2016-2018 (periudhë 3 -vjeçare), llogaritet se emigruan mbi 210,000 persona apo mbi 11.70% e popullsisë së Kosovës.

Stoku i migrimit neto

Gjatë periudhës 2016-2018 (periudhë 3-vjeçare), në Kosovë imigruan (kryesisht kosovarë të kthyer) mbi 60,672 banorë, ndërsa emigruan mbi 210,170 banorë dhe Kosova gjatë kësaj periudhe u zvogëlua për më shumë se 149,498 banorë.

Tabela 4: Stoqet e emigrimit dhe rrjedhja e migrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2016-2018

Viti	Gjithsej popullsia	Rrjedhat e imigrimit (numra absolutë)	Rrjedhat e emigrimit (numra absolutë)	Rrjedhat neto të emigrimit, sipas viteve	Stoku neto I migrimit (numra absolutë)	Stoku neto (në raport me shpërndarjen e popullsisë)
2016	1,783,531	13,072	22,012	-8,940	827,365	46.39
2017	1,798,506	5,832	11,263	-5,431	832,796	46.30
2018	1,795,666	6,762	28,164	-21,402	854,198	47.57

Burim: ASK

Nëse merret si bazë popullsia që jetonte jashtë vendit më 1 prill 2011 (më shumë se 703,000 banorë vlerësohet se jetonin jashtë vendit), në fund të vitit 2018 vlerësohet se mbi 854,198 banorë apo 47.57% e popullsisë së Kosovës jetonin jashtë vendit.

3. Migrimi i rregullt me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore

Ky kapitull përmban informacione të nevojshme rreth të dhënave dhe shërbimeve për këshillim për menaxhimin e migrimit të rregullt, me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore. Menaxhimi i migrimit të rregullt vazhdon të jetë përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht Divizioni për të Huaj në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), është autoriteti shtetëror përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për pajisje me lejet e qëndrimit të përkohshëm (përfshirë lejeqëndrimet për qëllim punësimi), dhe të përhershme në Republikën e Kosovës. DSHAM⁵ vendos pa miratimin e APRK-së për lejeqëndrim për qëllim pune, përderisa nuk ka kuotë të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në bazë të Ligjit për të Huaj, APRK/MPMS lëshon leje pune afatëshkurtër për të huaj, në kohëzgjatje prej 30 ditëve, 60 ditëve dhe 90 ditëve, në një periudhë kohore prej 180 ditëve, brenda vitit.

APRK-ja është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale për të huajt, të cilët kanë qasje në tregun e punës në Republikën e Kosovës. MPMS-ja⁶ është gjithashtu përgjegjëse për vendosjen e bashkëpunimit në fushën e shërbimeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale përmes marrëveshjeve bilaterale me shtetet e ndryshme, kryesisht të shteteve të Bashkimit Evropian. Po ashtu, APRK ofron shërbime këshillimi, informimi, trajnime profesionale dhe lehtësim të punësimit për punëkërkuarë kosovarë të cilët kërkojnë punësim jashtë vendit.

3.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Duke pasur parasysh ndryshimet legislative në nivel të BE-së në fushën e migrimit si dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së në kuadër të zbatimit të MSA-së,

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876> (neni 20 paragrafi 6)

⁶ <http://www.aprk.rks-gov.net>

Ministria e Punëve të Brendshme ka ndryshuar dhe plotësuar Ligjin për të Huajt.⁷ Ligji Nr. 06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, është miratuar nga Kuvendi me 30 mars 2018 dhe shpallur në Gazetën Zyrtare me datë 03 maj 2018).⁸

Shërbimet e ofruara për të huajt të cilët arrijnë në Kosovë për qëllime punësimi, janë të rregulluara me Ligjin për të Huajt. Me këtë ligj rregullohet hyrja, qëndrimi – punësimi dhe largimi i të huajve.

Ligji Nr. 04/L-205⁹ për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, përcakton qartë përgjegjësitë e Agjencisë së Punësimit për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në lidhje me punësimin e të huajve. APRK-ja përmes divizionit përkatës jep informata dhe këshilla për të huajt të cilët imigrojnë në Kosovë për qëllime të punësimit dhe ofron shërbime për punëkërkuesit kosovarë të cilët kërkojnë punësim jashtë vendit. Edhe përmes Zyrave të Punësimit dhe Qendrave të Aftësimit Profesional, janë ofruar shërbime të migrimit për punësim dhe aftësim profesional.

Ligji për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënësit¹⁰, rregullon shërbimet të cilat u duhen ofruar punëkërkuesve kosovarë që kanë për qëllim punësimin jashtë vendit.

Edhe në vitin 2018, APRK-ja ka vazhduar me zbatimin e disa programeve për të përkrahur kosovarët që vendosin të emigrojnë për qëllime të punësimit. Po ashtu, MPMS-ja/ APRK-ja në bashkëpunim me GIZ-in dhe Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë (DIMAK), ka vazhduar bashkëpunimin i cili përfshin një sërë shërbimesh informuese dhe këshillimesh në fushën e migrimit. Në këtë drejtim memorandumet e nënshkruara në vitin paraprak janë në proces të zbatimit.

⁷ Direktiva 2014/66/BE, e Parlamentit dhe Këshillit Europian, që ka të bëjë me kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta brenda kornizës së transfereve brenda-korporatave, Direktiva 2014/36/BE, e Parlamentit dhe Këshillit Europian për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime të punësimit si punëtorë sezonalë dhe Direktiva 2016/801 BE, e Parlamentit dhe Këshillit Europian, e datës 11 maj 2016, për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime hulumtimi, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, skema të shkëmbimit të nxënësve, apo projekte arsimore, si dhe au pair-ve.

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16333>.

⁹ Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

¹⁰ Ligji Nr. 05/L -077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënësit, Neni 8.

- Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Landesverband Bayerischer Bauinnungen dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ), që synon përmirësimin e mundësive për arsimim dhe aftësimin profesional në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2018, të rinjëve nga Republika e Kosovës iu është ofruar mundësia e arsimimit dhe aftësimit profesional në sistemin dytësor 2-vjeçar në Gjermani, në fushën e ndërtimit; dhe
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Fondacionit Besa dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ), me të cilin synohet migrimi qarkor dhe lëvizshmërisë përmes përmirësimit të arsimit dhe aftësimit. Gjatë vitit 2018 nga ky program kanë përfituar 18 kandidatë të cilët kanë qenë pjesë e programeve për punësim dhe aftësim në Gjermani, dhe të cilët monitorohen nga Agjencia (APRK).

3.3. Statistikat

Imigrimi i rregullt


Gjatë vitit 2018 janë lëshuar gjithsej 4,925 lejeqëndrime të përkohshëm. Për bashkim familjarë janë lëshuar 1,680 (34%), me qëllim punësimi, 2,899 (58.9%), për studim/shkollim 210 (4.3%) dhe për arsye të tjera 136 (2.8%). Sipas strukturës gjinore janë lëshuar: 2,610 (53%) për gjininë mashkullore, ndërsa 2,315 (47%) për gjininë femërore.

Sipas statistikave, numri i të huajve me leje qëndrimi të përkohshëm krahasuar me vitin paraprak ka rënie të vogël. Kështu, në vitin 2018, numri i të huajve me leje qëndrimi të përkohshëm është më i vogël për 7.3% krahasuar me vitin 2017 (5,283).

Në përgjithësi, numri i të huajve me leje qëndrimi të përkohshëm në periudhën kohore 2016 - 2018 tregon një trend në rritje.

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përkohshëm të lëshuara janë: Turqia (29.3%), Shqipëria (25.5%), Serbia (12.5%), Maqedonia e Veriut (8.9%), SHBA (5.8%), dhe shtetet e tjera (17.9%).

Figura 3: Trendi i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit (2016 - 2018)



Burimi: MPB/DSHAM

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi, edhe në vitin 2018 (2,899) ishte pothuajë i njëjtë me vitin paraprak (2,865) (siç vërehet edhe në figurën 3) me një tendencë rritjeje të vogël (1.2%). Nëse krahasojmë vitin 2018 me vitin 2016 (2,296) vërehet një rritje e dukshme prej 26,3%.

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi janë: Turqia (34.2%), Shqipëria (25.3%), Serbia (7.5%), Maqedonia e Veriut (8.7%), SHBA (6.0%), dhe shtetet e tjera (18.3%).

Faktorët që mund të kenë ndikuar në rritjen e punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës për periudhën 3-vjeçare mund të jenë të ndërlidhur me operimin e kompanive të huaja në vend si Bektel Enka (sektori i Ndërtimtarisë), Limaku (Transporti dhe Komunikimi) dhe KEDS (shpërndarja e rrjetit të rrymës) me mbi 50 % të të punësuarve të huaj në Kosovë. Ndërsa përqindja tjetër janë në: Tregti dhe Hotelieri/Gastronomi.

Lejet e qëndrimit të përhershëm

Numri i përgjithshëm i lejeve të qëndrimit të përhershëm të lëshuara gjatë vitit 2018 ishte 58 e që në krahasim me vitin paraprak (67), kjo tregon një rënie për 15.5%. Nga numri i përgjithshëm i lejeqëndrimeve të përhershme të dhëna në vitin 2018, 31 (54%) janë meshkuj, kurse 27 (46%) janë femra.

Lejet e qëndrimit të përhershëm janë lëshuar për arsye të ndryshme si: bashkim familjarë 15 (25.9%), punësim 22 (37.9%), studim 0 (0%) dhe arsye të tjera 21 (36.2%).

Lejet e qëndrimit të përhershëm janë lëshuar kryesisht për shtetasit nga: Turqia (25.9%), Shqipëria (24.1%), Gjermania (19%), Austria (8.6%), Mali i Zi (3.4%), dhe shtetet e tjera (19%).

Leje pune afatshkurta¹¹

Gjatë vitit 2018, APRK ka lëshuar 446 leje pune afatshkurtër për shtetas të huaj, ku nga ky numër 60 leje pune afatshkurtër kanë qenë vazhdim. Sipas raportit, ky është numër i konsiderueshëm krahas vitit paraprak dhe vlen të theksohet se shumica e tyre i takojnë kategorive të ekspertëve dhe trajnerëve për punëtorët e Kosovës.

Leje pune afatshkurtër sipas gjinisë (446 persona, prej të cilëve meshkuj 395 dhe 51 femra) dhe sipas shtetësisë (Spanjë, 79 (18%); Maqedoni e Veriut 66 (15%); Kroaci 40 (9%); Poloni, 35 (8%); Gjermania 29 (6%); dhe të tjera 197(44%).

Emigrimi i rregullt


Shtetasit e Republikës së Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen

Për shtetasit e Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2018, kishte 37,423 leje qëndrimi të vlefshme të gjitha kategorive në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen. Numri i lejeve të vlefshme të qëndrimit, bazuar në të dhëna të Eurostatit është rritur për 23.3% krahasuar me vitin paraprak (28,703).

Në fund të vitit 2018, më shumë se gjysma (52%) të të gjitha lejeve të qëndrimit ishin të lidhura me bashkim familjarë, për arsye punësimi (30%) kurse për arsye arsim (3%). Lejet e qëndrimit të klasifikuara për arsye të tjera përbënin 15% të të gjitha lejeve të vlefshme të qëndrimit. Gjermania regjistroi 18,986 (54.2%) shtetas të Republikës së Kosovës me leje të vlefshme qëndrimit, Sllovenia 3,819 (10,9%), Italia 2,842 (8,1%) persona, Kroacia 2,065 (5.9%) dhe shtete tjera rreth 20%.

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876> neni 22, Leja e punës afatshkurtër deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt si vijon

Figura 4: Emigrantët kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Shengen, sipas arsyes së qëndrimit, 2016-2018



Burimi: Eurostat : <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-igration/data/database>

Rritja e numrit të përgjithshëm të lejeve të vlefshme të qëndrimit në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, sipas kategorive ishte më e larta tek kategoria e punësimit e cila pati rritje për 62%, e pasuar nga lejet e vlefshme të lëshuara për arsye të edukimit me një rritje prej 44%, bashkimit familjarë për 26% dhe kategoria nën tjera për -0.1%.

Sipas shteteve, numri i lejeve të vlefshme të qëndrimit për arsye punësimi gjatë periudhës tre-vjeçare (2016-2018) ishte: Gjermani 56%, Slloveni 20%, Kroacia 10% dhe shtetet tjera me 14%, kurse për kategorinë e edukimit prin Gjermania me 28%, Austria me 21%, Polonia me 7%, Sllovenia me 5% dhe shtetet tjera 39%.

4. Migrimi i parregullt

Migrimi i parregullt edhe gjatë vitit 2018 ka mbetur ndër prioritetet për institucionet e Republikës së Kosovës, si në aspektin e emigrimit, ashtu edhe në atë të imigrimit.

4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të migrimit, duke përfshirë ato që ndërlidhen me migrimin e parregullt, çështjet e azilit dhe refugjatëve, si dhe ndan përgjegjësinë për zbatimin e politikave që ndërlidhen me imigrim të parregullt në Republikën e Kosovës.

Departamenti i Policisë Kufitare, në kuadër të Policisë së Kosovës, është përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Departamenti i Policisë Kufitare, në kuadër të menaxhimit dhe kontrollit të kufirit shtetëror, si dhe Drejtoria e Hetimit të Krimit të Organizuar (DKKO) në kuadër të Departamentit të Hetimeve merren me parandalimin dhe luftimin e kontrabandimit me migrantë.

Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), është drejtori e specializuar e Policisë së Kosovës e ngarkuar me përgjegjësinë për hetimin e rasteve dhe veprave të tjera që ndërlidhen me trafikimin me njerëz.

4.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar politikat dhe kornizën ligjore¹² me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt, luftimit të kontrabandimit me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore. Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 janë përqendruar në avancimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore me legjislacionin e BE-së, ku është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt i cili është është

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Kodi Penal i Kosovës, (KPK); Kodi i drejtësisë për të mitur; Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK); Ligji për Policinë e Republikës së Kosovës; Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit; Ligji për të Huajt; Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit; Ligji për Shëndetësi; Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2015-2019; Strategjia e punës e DHTQNJ-së dhe Plani Vjetor i Veprimit; Aktet e tjera normative të PK-së (Udhëzimet Administrative, Parimet, Procedurat Standarde të Operimit dhe vendimet); Procedurat Standarde të veprimit për viktimat e trafikimit; Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit; Strategjia afatgjate për reintegrimin e viktimave të trafikimit.

miratuar nga Kuvendi me datën 30 mars 2018 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare me 03 maj 2018.¹³ Kurse për vitin 2019 janë paraparë të ndryshohen dhe plotësohen edhe aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për të Huajt, me qëllim të harmonizimit me legjislacion të BE-së. Duke u bazuar në ndryshimet ligjore, MPB në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombtare për Migrim (ONM) ka inicuar memorandumun e mirëkuptimit, në programin e kthimit të asistuar vullnetarë, e cila pritet të nënshkruhet gjatë vitit 2019.

Në bazë të analizës rreth vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Migrim 2013-2018 ka filluar hartimi i Projekt-Strategjisë për Migrim 2019-2023.

Ministria e Punëve të Brendshme ka ndryshuar dhe ka plotësuar Ligjin Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe është miratuar në Kuvend më 30 mars 2018.

Edhe gjatë vitit 2018, Zyra e Koordinatorit Nacional Kundërtrafikim në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe me partnerët e tjerë me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve, ka organizuar fushatën vetëdijësuese në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

4.3. Statistikat

Imigrimi i parregullt

Refuzimi i hyrjeve

Gjatë vitit 2018, 2,016 personave iu është refuzuar hyrja në të gjitha pikat e kalimit kufitar (PKK), duke shënuar një rënie prej 28% në krahasim me vitin 2017, dhe një rënie prej 26% në krahasim me vitin 2016.

Tabela 5: Refuzim i Hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare, 2016-2018

Viti	2016	2017	2018
Numri i personave	2,742	2,813	2,016

Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës

¹³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16333>


Nga numri i përgjithshëm i personave të refuzuar në hyrje të kufirit në vitin 2018, 89% janë nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, 9% nga shtetet aziatike, 2% nga shtetet afrikane dhe Amerika, Kanada dhe Australia. Nëse i krahasojmë këto shifra me vitin 2017, ku nga totali i personave të refuzuar në hyrje 94.6% ishin nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, 4% nga shtetet aziatike, 2% nga shtetet afrikane, SHBA-ja, Kanada dhe Australia, shohim se kemi rënie të refuzimit të hyrjeve për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen për 5.6%, por kemi rritje të refuzimeve për shtetasit e shteteve të Azisë.

Arsyet për refuzim të hyrjeve në kufi janë të ndryshme si: shtetasve të shteteve fqinje si: Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, u është refuzuar hyrja për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme, ose për shkak të shkeljeve të tjera, ndërsa shtetasve të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen iu është refuzuar hyrja për shkak të mungesës së pasaportave dhe të letërnjoftimeve biometrike. Shtetasve të shteteve aziatike dhe afrikane në anën tjetër u është refuzuar hyrja për shkak se nuk kanë pasur viza për të hyrë në Kosovë, apo nuk kanë pasur mjete të mjaftueshme për jetesë dhe nuk kanë mundur ta justifikojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit.

Kalimi i paautorizuar i kufirit

Gjatë vitit 2018, 505 imigrantë të parregullt kanë kaluar kufirin dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paautorizuar. Krahasuar me vitin 2017, vërehet një rritje e konsiderueshme prej 282%, ndërsa në krahasim me vitin 2016 kemi një rritje prej 65%.

Figura 5: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar 2016-2018



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës


Nga numri i përgjithshëm i imigrantëve të parregullt (505), numri më i madh i tyre është nga Siria (239), Palestina (70), Algjeria (41), Maroku (36), Libia (34), Iraku (33), Pakistani (19), Irani (18), Afganistani (7), Shqipëri 2, Maqedonia e Veriut 2, Tunizi 2, Afrikë Qendrore 1 dhe Eritre 1. Gjinia mashkullore përfaqësohet me 99% (498) imigrantë të parregullt, ndërsa gjinia femërore me 1% (7). Për nga grup mosha, 5% imigrantë të parregullt ishin të moshës nën 18 vjeç, ndërsa 95% të moshës madhore (mbi 18 vjeç).

Rastet e trajtuara tregojnë se imigrantët e parregullt kanë lëvizur në grupe të vogla, të ndihmuar nga kontrabandistët, të cilët në territorin e Republikës së Kosovës kanë hyrë përmes kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Nga 505 imigrantë të parregullt, 498 janë raportuar ta kenë kaluar kufirin në mënyrë të paautorizuar duke përdorur rrugët ilegale përgjatë vijës së gjelbër të kufirit, ndërsa 7 kanë hyrë si klandestinë duke përdorur pikë kalimet kufitare. Republika e Kosovës kryesisht konsiderohet si vend transit nga imigrantët e parregullt dhe nuk është shtet i destinimit përfundimtar, pasi që ata synim kryesor kanë migrimin në shtetet e BE-së.

Luftimi i kontrabandimit me migrantë

Gjatë vitit 2018, Policia e Kosovës ka vazhduar kontrollet sistematike dhe të hollësishme në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kontrabandimit me migrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të Republikës së Kosovës të cilët janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Figura 6: Rastet e iniciuara të kontrabandës me migrantë, 2016-2018



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria e Hetimit të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

Gjatë vitit 2018, kemi një rënie prej 17% të hetimit të rasteve të kontrabandimit me migrantë në krahasim me vitin 2017, ndërsa vërehet një ngritje prej 41% në krahasim me vitin 2016.

Gjatë vitit 2018, numri i personave të dyshuar për kontrabandë me migrantë ishte më i ulët për 35% krahasuar me vitin 2017, ndërsa më i ulët për 23% në krahasim me vitin 2016. Nga 77 persona të dyshuar për kontrabandë me migrantë, 70% ishin shtetas të Republikës së Kosovës, 18% shtetat të Republikës së Shqipërisë, 8% të Serbisë, 3% të Turqisë, dhe 1% të Maqedonisë së Veriut.

Tabela 6: Të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shtetësisë, 2016-2018

Shtetësia	2016	2017	2018	Total
Kosovë	15	27	12	54
Shqipëri	8	1	5	14
Serbi	3	1	2	6
Turqi	0	1	1	2
Maqedoni e Veriut	0	1	0	1
Total	26	31	20	77

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria e Hetimit të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

Trafikimi me Qenie Njerëzore¹⁴

Të dhënat vjetore tregojnë se gjatë vitit 2018 janë identifikuar 3 viktima të trafikimit, krahasuar me me vitin 2017 që ishin 7 viktima të identifikuar, dhe kjo tregon një ulje e kësaj dukurie për 4 persona. Sipas shtetësisë, 2 viktima të identifikuar ishin nga Shqipëria dhe 1 nga Republika Çeke. Të gjitha viktimat ishin të gjinisë femërore. Njëra nga viktimat e Republikës së Shqipërisë dhe 1 nga Çekia janë riatdhesuar vullnetarisht, dhe sipas ligjit iu është ofruar strehim dhe shërbime të parapara sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar (strehim, kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, arsim dhe punë). Janë nënshkruar protokolle të bashkëpunimit, si dhe përdorimi i formave unike të komunikimit me: Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Malin e Zi në luftën kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.

¹⁴ Për qëllime të këtij Profili janë marrë për bazë vetëm viktimat e huaja të trafikuar në Republikën e Kosovës dhe viktimat vendore të trafikuar jashtë R. Kosovës.

Emigrimi i parregullt

Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë kapur në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen¹⁵

Gjatë vitit 2018, iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen 1,520 shtetas kosovarë, e që në krahasim me vitin 2017 (1,600) shënon një rënie prej - 5.2%. Refuzimi i hyrjeve në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen kryesisht ka ndodhur në kufijtë tokësorë (84% ose 1,295 persona), kurse në kufijtë detarë (3% ose 45 persona) dhe kufijtë ajror (13% ose 195 persona).

Refuzimi i hyrjes është bërë për arsye të mungesës së vizës apo të qëndrimit të vlefshëm në 61% të rasteve (820), mungesës së dokumentit të vlefshëm në 36% të rasteve (485), dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit në 2% të rasteve (30), si dhe vizës apo lejes së falsifikuar të qëndrimit në 1% të rasteve (20).

Numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë të cilëve më së shumti iu është refuzuar hyrja në kufi sipas shteteve, ishte i ngjashëm me dy vitet paraprake ku prinë: Franca me 33%, Kroacia me 28%, Hungaria me 12%, Sllovenia me 12% (që krahasuar me vitin paraprak (110) ka rritje prej 37% (175) dhe shtetet e tjera me 15%.

Shtetasit kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të paligjshëm brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen¹⁶

Numri i shtetasve kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të paligjshëm brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, tregon një rënie të vazhdueshme në tri vitet e fundit. Në bazë të këtyre të dhënave të kategorizuara sipas gjinisë ka dominuar gjinia mashkullore me 82% (4,875), krahasuar me gjininë femrore me 18% (1,040). Kurse sipas grupmoshës ka domininua grupmosha 18-34 vjeç me 90% (3,365), grupmosha nën 18 vjeç ka qenë me 10% (385). Rënia në vitin 2018 (5,945) krahasuar me vitin 2017 (7,835) ishte -30.9%. Kjo rënie është për faktin se gjatë kësaj periudhe sikurse edhe dy vitet paraprake nuk ka pasur lëvizje të theksuara të emigrantëve të parregullt dhe tregon se shtetasit kosovarë nuk janë të interesuar që t'i ndjekin rrugët e pa rregullta të emigrimit.

¹⁵ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar me 25.06.2019.

¹⁶ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar e 26.06.19

Numri i shtetasve kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas shteteve: Gjermania - 41% (2,460), Zvicra - 18% (1,085), Franca - 13% (770), Kroacia - 7% (390), Austria - 6% (335), Hungaria - 5% (285), dhe shtetet e tjera - 10% (610).

Shtetasit kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen me urdhër për largim¹⁷

Numri i shtetasve kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, me urdhër për largim në vitin 2018 (5,865), tregon një rënie prej - 29%, krahasuar me vitin 2017 (7,570). Kjo rënie sikurse edhe në dy vitet paraprake është rezultat i rënies së vazhdueshme të emigrimit të parregullt.

Numri i shtetasve kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, me urdhër për largim sipas shteteve, ka ndryshuar në renditje krahasuar me vitin paraprak: Franca - 40% (2,325), Gjermania - 15% (890), Kroacia - 8% (460), Zvicra - 8% (450), Belgjika - 6% (365), dhe nga shtetet e tjera me 23% (1,375).


Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim¹⁸

Numri i shtetasve kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim gjatë vitit 2018 ishte 3,340 persona, e që krahasuar me vitin 2017 (6,110) tregon rënie të dukshme prej rreth 90%. Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim, ishin nga Gjermania me 52% (1,740), Franca me 9% (305), Kroacia me 9% (305), Suedia me 9% (290), Austria me 5% (190) dhe shtetet e tjera me 15% (510).

¹⁷ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar e 26.06.19.

¹⁸ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar më 23.05.2018.

Figura 7: Shtetasit kosovarë të cilëve iu ka refuzuar hyrja në kufi; janë zënë me qëndrim të paligjshëm; janë urdhëruar të largohen dhe janë larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, 2016 - 2018



Burimi: Eurostat

5. Kthimi, ripranimi dhe riintegrimi

Ky kapitull përfshin një përmbledhje të procesit të kthimit, ripranimit dhe riintegrimin, me të dhëna të hollësishme rreth numrit të të kthyerve vullnetarë dhe atyre të kthyer me forcë. Kapitulli mbulon si kthimin e shtetasve të huaj, ashtu edhe kthimin e kosovarëve në vendin e tyre.

5.1. Kthimi i të huajve

5.1.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (në kuadër të MPB-së) dhe Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) në kuadër të PK-së janë autoritetet përgjegjëse për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, në vendet e origjinës apo në vendin e fundit të qëndrimit të të huajve.

5.1.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Strategjia Kombëtare për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, përbën kornizën kryesore strategjike shtetërore e cila përfshin edhe politikat e kthimit të të huajve me qëndrim të paligjshëm në Kosovë, si dhe rregullimin e mekanizmave përkatës për zbatimin e politikave.

Vendimi për largim vullnetar është masë administrative që buron nga Ligji për të Huajt, ndërsa autoritetet përgjegjëse për lëshimin e vendimit për largim vullnetar janë:

- Divizioni për të Huaj i cili lëshon vendim për largim vullnetar në rastet kur refuzohet kërkesa për lejqëndrim dhe revokim të lejqëndrimit, ndërsa në raste tjera është përgjegjësi e DMH-së. Nëse largimi shoqërohet me masë ndaluese, afati i ndalimit të hyrjes nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) muaj e as më i gjatë se pesë (5) vjet.
- Në rast të mosrespektimit të vendimit për largim vullnetar si dhe kundërvajtjeve të tjera sipas nenit 97¹⁹ të Ligjit për të Huajt dhe Udhëzimit Administrativ (MPB) 09-2014 për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, DMH-ja ndaj të huajt lëshon dhe ekzekuton vendimin për largim me forcë. Afati i ndalimit të hyrjes nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) muaj e as më i gjatë se pesë (5) vjet.


¹⁹ Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

5.1.3. Statistikat

Vendim për largim vullnetar

Të dhënat vjetore tregojnë se numri i Vendimeve²⁰ për largim vullnetar gjatë vitit 2018 (178), ishte më i lartë se në vitin paraprak (111).

Figura 8: Vendim për largim Vullnetar, 2016 – 2018



Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huajt

Numri më i madh i vendimeve për largim vullnetar të lëshuara ishin ndaj shtetasve të Shqipërisë në 73% të rasteve (130), kurse 27% ishin nga shtetet e tjera.

Në bazë të këtyre të dhënave, te numri i vendimeve për largim vullnetar të kategorizuara sipas gjinisë ka dominuar gjinia femërore me 78%, krahasuar me gjininë mashkullore me 22%. Ndër arsytet e lëshimit të vendimeve për largim vullnetar ndaj të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, ka qenë mungesa e lejes së vlefshme të qëndrimit, anulimi ose revokimi i lejes së qëndrimit, ose janë gjetur duke punuar në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin për të Huajt ose me ligjet e tjera në fuqi.

Në kuadër të programit të kthimit të asistuar vullnetar, ONM ka ndihmuar në kthimin dhe riintegrimin e dy personavë në shtetin e orgjinës (Algjeri).


Vendim²¹ për largim me forcë

Gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar 247 Vendime për largim me forcë, që paraqet një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2017, ndërsa ka një rënie prej 27% krahasuar me vitin 2016.

²⁰ Me ndryshimin dhe plotsimin e e ligjit për të Huajt, Urdhër largimi vullnetar është zëvendësuar me Vendim për largim vullnetar.

²¹ Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Huajt, termi Urdhër është zëvendësuar me Vendim (neni 31).

Figura 9: Vendim për largim me forcë, 2016 – 2018



Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

Kjo rënie e vendimeve të largimit me forcë në dy vitet e fundit në krahasim me vitin 2016 është rezultat i inspektimeve që janë bërë te bizneset e ndryshme që kanë të punësuar shtetas të huaj, si dhe falë shpërndarjes së broshurave informuese për shtetasit jo kosovarë në pikë kalimet kufitare në hyrje, ku janë njoftuar me procedurat e qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës.

Sipas gjinisë 56% e të depërtuarve me vendim largim me forcë kanë qenë të gjinisë femërore ndërsa 44% të gjinisë mashkullore.

Sipas shtetësisë, 91% kanë qenë nga Shqipëria, 3% nga Turqia, 3% nga Serbia dhe 3% nga vendet e tjera.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj ka deportuar nga Republika e Kosovës 24 persona me vendim të gjykatave të Kosovës, duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Krahasuar me vitin 2017 kemi një rritje për 50%, ndërsa me vitin 2016 një rritje prej 41%. Nga këto deportime, 17 persona ishin shtetas të Shqipërisë, 3 të Turqisë, 2 të Bullgarisë dhe 2 të Serbisë.

5.2. Ripranimi

5.2.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim/Divizioni për Ripranim dhe Kthim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/1-208 për Ripranim dhe marrëveshjeve bilaterale të ripranimit.

5.2.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Ligji për Ripranim përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje ose qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Zbatimi i legjislacionit për ripranimin ka përparësi në aspektin e bashkëpunimit për ripranimin me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Deri më tani Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 24 vende^[1], 20 prej të cilave janë me vendet anëtare të BE dhe vendet e Shengenit.

5.2.3. Statistikat

Edhe në vitin 2018 ka vazhduar zbatimi i Ligjit për Ripranim, si dhe marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit, rreth 94% e rasteve të ripranimit u trajtuan në bazë të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit me vendet anëtare të BE-së, 5% e rasteve të ripranimit u bazuan në marrëveshjet dypalëshe të ripranimit me vendet jo anëtare të BE-së, ndërsa më pak se 1% e rasteve të ripranimit u trajtuan në përputhje me Ligjin për Ripranim.

Të dhënat vjetore tregojnë se në vitin 2018 janë ripranuar 2,395²² persona, me qëndrim të parregullt në shtetet e BE-së dhe zonës Shengen, që përbën një rënie prej 47% krahasuar me vitin paraprak (4,509). Sipas mënyrës së kthimit 70% (1,668) janë kthyer me forcë kurse 30% (727) janë të kthyer vullnetarë të asistuar nga IOM-i.


[1] 2009 Republika e Shqipërisë, 2009 Republika e Francës, 2010 Këshilli Federal Zvicëran, 2010 Gjermania, 2010 Mbretëria e Danimarkës, 2010 Republika e Austrisë, 2010 Mbretëria e Norvegjisë, 2011 Republika e Sllovenisë, 2011 Beneluxi (Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg), 2011 Republika e Çekisë, 2011 Mali i Zi, 2011 Mbretëria e Suedisë, 2011 Republika e Finlandës, 2012 Republika e Hungarisë, 2012 Republika e Bullgarisë, 2012 Republika Maltëse, 2013 Republika e Estoneze, 2013 Principata e Lihtenshtajnit, 2013 Republika e Kroacisë, 2014 Republika e Italisë, 2015 Republika e Turqisë dhe 2017 Republika e Maqedonisë së Veriut.

²² Numri i të ripranuarve me forcë dhe vullnetarë është llogaritur në baze të ripranuarve me forcë sipas të dhënave të PK dhe DSHAM-së, si dhe të kthyer vullnetarë të asistuar nga IOM për vitin 2018.

Nga numri i përgjithshëm, sipas gjinisë, njëjtë sikurse edhe vitin paraprak gjinia mashkullore prinë me 70% (1,158 persona) në krahasim me gjininë femrore me 30% (510 persona).

Gjinia mashkullore përbën përqindjen më të madhe të të ripranuarve me forcë me 70%, të cilët janë të moshës ndërmjet 18-34 vjeç dhe që kanë qëndruar më pak se gjashtë muaj në shtetet evropiane. Kjo tregon se ata që ripranohen janë të moshës së re (aktive për punë), kryesisht meshkuj që e kanë lëshuar Republikën e Kosovës. Po ashtu, edhe sa i përket të kthyerve të asistuar vullnetarë nga ONM, prin gjinia mashkullore me 63% (458) kurse gjinia femërore me 37% (269).

Figura 10: Ripranimi vullnetar dhe me forcë, 2016–2018



Burimi: DSHAM, PK, ONM

Nga numri i përgjithshëm sipas moshës prin grupmoshat 18-34 (975 ose 41%) dhe 35-64 (722 ose 30), kurse grupmoshat 0-5 (284 ose 12%) dhe 6-13 (274 ose 11%) kanë numër më të vogël.

Në bazë të moshës shkollore (6-17) vjeç, numri i të ripranuarve me forcë i kësaj moshe për vitin 2018 është 276 ose 16%. Ndërsa, numri i të ripranuarve vullnetarë të asistuar nga ONM të moshës shkollore (6-17) vjeç është 128 ose 17%.

Sipas të dhënave vjetore për vitin 2018, numri më i madh i të ripranuarve me forcë ishte nga Gjermania 71% (1,187), Zvicra 10.3% (172), Franca 4.7% (78), Suedia 3.3% (55), Austria 2.7% (45) dhe shtetet tjera me 7.9% (131).

Sipas të dhënave vjetore të ONM për vitin 2018 numri më i madh i të ripranuarve është nga Gjermania me 75% (546), Austri 12% (88), Luxemburg 6.3% (46), Belgjikë 18% (2.5), Zvicër 1.9% (14) dhe shtetet tjera me 2.1% (15).

Trendi i të ripranuarve përgjatë tri viteve të fundit siç shihet edhe nga figura nr 9. ka qenë në rënie të vazhdueshme.

5.3. Riintegrimi

5.3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR-ja) është organi përgjegjës për menaxhimin e riintegrit të personave të riatdhesuar, përfshirë hartimin e politikave, legjislacionin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të riintegrit. Institucionet qendrore dhe lokale të përfshira në zbatimin e programit për riintegrim janë: MPMS-ja, MASHT-i, MMPH-ja, MSH-ja, MAPL-ja, MBPZHR-ja, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe drejtoritë e tjera përkatëse komunale.

5.3.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e riintegrit të personave të riatdhesuar, janë të përcaktuar me Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Planin e Veprimit 2018 – 2022, të cilat janë miratuar në Mars 2018.

Institucionet përgjegjëse, kriteret dhe procedurat ndihmëse dhe mbështetëse të personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegrit, rregullohen me Rregulloren (QRK) Nr. 13/2017 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, e cila gjatë vitit 2019 parashihet që të bëhet plotësim ndryshimi i kësaj Rregullore.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të politikave të riintegrit²³ gjatë kësaj periudhe, Ministria e Punëve të Brendshme/DRPR, ka përcaktuar mënyrat dhe formatin e

²³ Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe miratuar :

- Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Rrezikut në Riintegrim ,Plani i Integritit për stafin e Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Miratimin e Planeve Lokale, Vlerësimi i nevojave specifike të grupeve të cënueshëm, Vlerësimi i projektit për shkëmbimin e informatave lidhur me riintegrimin e të kthyerve ndërmjet Kosovës dhe Suedisë.

bashkëpunimit dhe bashkërendimit me palët e interesit në nivel qendror dhe lokal. Gjithashtu, bashkëpunimi ka vazhduar edhe me organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile, si dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi²⁴ me shumë institucione vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për personat e riatdhesuar. Janë trajnuar me qindra zyrtarë komunal dhe përfaqësues të institucioneve të tjera relevante për zbatimin e Strategjisë, Planin e Veprimit, Rregulloreve, Udhëzuesve dhe dokumente të tjera.

5.3.3. Statistikat

Gjatë vitit 2018, në kuadër të skemave emergjente dhe të riintegrit të qëndrueshëm janë mbështetur 3,165 persona të riatdhesuar^[3], shtetas të Republikës së Kosovës, numër ky që është më i vogël për 45.3 % në krahasim me vitin 2016 (5,786 persona).

Sipas përkatësisë etnike numri më i madh i përfituesve gjatë vitit 2018 i takon komunitetit shqiptar me 50.4% (1,594), pastaj komunitetit rom me 7.4% (234), ashkali 11.4% (362), egjiptian 4% (127), dhe komuniteteve të tjera 26.8% (848).

Ndërsa, sipas komunave të origjinës për vitin 2018, numri më i madh i përfituesve në skemat e ndryshme për riintegrim është nga komuna e Fushë Kosovës me 7.6% (241) përfitues, Podujevës me 6.8% (215), Ferizaj me 6.1% (194), etj.

Numri më i madh i personave që kanë përfituar në skemat e ndryshme për riintegrim janë të riatdhesuarit nga Gjermania me 65.2% (2,065), Franca me 2.1% (65) dhe Suedia me 2.1% (65) etj.


Në kuadër të skemave të ndryshme për Riintegrim, kujdes i veçantë i është kushtuar fëmijëve dhe grupeve të cënueshme, dhe gjatë viteve 2017 dhe 2018 janë mbështetur 121 persona të riatdhesuar të kësaj kategorie.

Në vijim janë paraqitur të dhënat për mbështetjen e personave të riatdhesuar sipas skemave të përfitimit.

²⁴Marrëveshjet përfshijnë institucione qeveritare, organizata të shoqërisë civile dhe donatorë të ndryshëm (MASHT, MPMS, GIZ, DIMAK, UNDP, OJQ Monitor, N.SH D&D Business Support Center etj).


^[3]Numri i përfituesve prej 3,165 personave gjatë vitin 2018 paraqet përfituesit e ri dhe të bartur, prej tyre 2,365 persona janë mbështetur në skemat e ndryshme për Riintegrim dhe 800 persona janë mbështetur nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare të cilat janë të dhëna statistikore.

Figura 11: Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente²⁵ brenda 12 muajve pas riatdhesimit, 2016 – 2018



Burimi: DRPR/MPB

Figura 12: Ndhimja për riintegrim të qëndrueshëm, 2016 – 2018



Burimi: DRPR/MPB

²⁵ Akomodim me qera deri ne 12 muaj, për vitin 2016 kanë qenë (202 banesa/familje më 737 persona), në vitin 2017 kemi (185 banesa/familje më 653 persona), si dhe në vitin 2018 kemi (124 banesa/familje më 365 persona).

Në kuadër të skemave për riintegrim të qëndrueshëm, gjatë periudhës 2016-2018 vërehet një rritje e konsiderueshme në skemën për financim themelim biznesi. Në vitin 2018 vërehet një rritje për 42.5% (400 përfitues) në krahasimin me vitin 2017 (230 përfitues). Rritje po ashtu ka pasur edhe në skemat e shërbimeve të konsulencës, si dhe skema tjera.

6. Integrimi

Integrimi i të huajve në shoqërinë kosovare është i rregulluar përmes kornizës ligjore që ka të bëjë me Ligjin për të Huaj dhe Ligjin për Azil, si dhe një numri aktesh tjera ligjore në nivel qendror dhe lokal. Gjatë vitit 2018, është punuar në hartimin e rregullativës ligjore që ka të bëjë me përcaktimin e një mekanizmi qendror referues për integrimin e të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës, si dhe për definimin e procedurave dhe kritereve për këtë kategori.

6.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Integrimi i të huajve me qëndrim të ligjshëm në shoqërinë Kosovare është përgjegjësi e disa institucioneve qendrore dhe nivelit komunal.

Autoritetet shtetërore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për lehtësimin e integritit të të huajve në shoqërinë kosovare janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe komunat.

Gjatë vitit 2018 është punuar në hartimin e Rregullores për Integrimin e të Huajve, që ka për qëllim, përveç tjerash, edhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin dhe monitorimin e procesit të integritit të të huajve në shoqërinë Kosovare, si dhe mandaton Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në kuadër të MPB-së, si organin përgjegjës për integrimin e të huajve në nivel qendror.

6.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Integrimi i të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës është i rregulluar përmes një numri të akteve ligjore.

Kreu IX i Ligjit nr. 04/l-219 për të Huajt (nenet 126 dhe 127), siguron bazën ligjore për kushtet dhe shërbimet e integritit të të huajve në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore, përfshirë përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare me qëllim të promovimit dhe zbatimit të programeve për integrimin e të huajve në shoqëri.

Gjatë vitit 2018 është miratuar Ligji Nr. 06/L- 026 për Azil (neni 41), përmes të cilit parashihen masat për integrimin e personave me status refugjati dhe personave me status të mbrojtjes plotësuese në shoqërinë kosovare, përmes mundësimit të mësimin të historisë, gjuhës dhe kulturës në Republikën e Kosovës.

Legjislacioni në fuqi garanton të drejtën e fitimit të shtetësisë së Kosovës (përmes natyralizimit)²⁶ dhe qasjen në shërbime përkatëse me qëllim të lehtësimit të procesit të integrimin në shoqërinë kosovare.

Gjatë vitit 2018, Ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar Projekt-rregulloren për Integrimin e të Huajve në Kosovë. Kjo projekt-rregullore ka për qëllim përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe caktimin e autoriteteve përgjegjëse për procesin e integrimin të të huajve. Kategoritë e të huajve që janë subjekt i kësaj projekt-rregullore janë: azilkërkuesit, personat me status të refugjatit, personat me mbrojtje të përkohshme, personat me mbrojtje plotësuese, personat me qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm, si dhe personat me status pa shtetësi. Në bazë të projekt-rregullores, të huajt në procesin e integrimin gëzojnë të drejtën për arsim, kujdes shëndetësor, asistencë sociale, aftësim profesional dhe punësim, informim, strehim, si dhe shërbimet e tjera të garantuara me legjislacionin në fuqi. Projekt-rregullorja për integrimin e të huajve është finalizuar dhe pritet të miratohet gjatë vitit 2019.

6.3. Statistikat

Gjatë vitit 2018, shtetësinë e Republikës së Kosovës e kanë fituar gjithsej 349 persona, duke shënuar rritje prej 4% krahasuar me vitin 2017 (335). Sipas gjinisë, gjinia femërore prin me 57.3% (200) në krahasim me gjininë mashkullore me 42.6% (149).


Sipas ndarjes në bazë të grup-moshave të personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës janë: grupmosha 18-34 vjeç me 45% (156 persona), grup-mosha 35-64 vjeç me 45% (157 persona) dhe grup-moshat tjera me 10.3% (36 persona).

Sa i përket shtetësisë apo vendit të origjinës të të huajve të cilët kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2018 prin Shqipëria me 63% (220 persona), pasuar nga Serbia me 3.4% (12 persona), Turqia me 1.7% (6 persona), Bosna dhe Hercegovina me 1.7% (6 persona), dhe shtetet tjera me 30% (105 persona).

²⁶ Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Gazeta e Republikës së Kosovës/Nr. 33/2 Shtator 2013, Prishtinë

Ndërsa numri i personave të cilëve iu është refuzuar shtetësia e Republikës së Kosovës është 556. Numri i refuzimeve është për persona që i përkasin grup-moshës 18-34 vjeç me 39% (217 persona), grup-moshës 35-64 vjeç me 42% (233 persona), grup-mosha 14-17 vjeç me 3.6% (20 persona) dhe grup-moshave të tjera me 15.5% (86 persona).

Figura 13: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, 2016-2018



Burimi: DSHAM

Trendet tregojnë se në vitin 2018 ka pasur rritje të fitimit të shtetësisë dhe arsyeja kryesore e kësaj rritjeje është përmbushja e kriterëve ligjore të fitimit të shtetësisë, që ndërlidhet me plotësimin e periudhës kohore të qëndrimit në Republikën e Kosovës.

7. Migrimi dhe Zhvillimi

Në këtë kapitull jepet një përmbledhje e politikave dhe strategjive të Republikës së Kosovës që ndërlidhen me migrimin dhe zhvillimin. Fokusi është vënë në prezantimin e mënyrave se si mund të përdoret potenciali i migrimit për qëllime zhvillimore, dërgesat (remitenca) dhe investimet nga diaspora, si dhe politikat e angazhimit të kthimit të ekspertëve nga diaspora (kthimi i dijes).

7.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Duke u nisur nga fakti se Kosova ka diasporë të konsiderueshme (rreth 834,000 persona), rol kryesor në këtë fushë ka Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Krahas saj, edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Arsimit, ku në fushëveprimin e tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive të cilat në mënyrë direkte apo indirekte rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me migrimin dhe zhvillimin. Qëllimi i përbashkët është krijimi i një klime të favorshme në vend dhe në diasporë për promovimin e vlerave kulturore dhe tërheqjen e investimeve nga diaspora.

Në këtë drejtim Qeveria e Republikës së Kosovës përmes MDIS-së, angazhohet në ruajtjen e identitetit të pjesëtarëve të diasporës, organizimin e tyre në vendet ku jetojnë, si dhe promovimin e resurseve dhe mundësive për investimet e tyre në vendin e origjinës me qëllim të zhvillimit ekonomik.

MDIS ka nxitur dhe përkrahur themelimet e strukturave të organizimit të diasporës si rrjetet e bizneseve, rrjetet e profesionistëve, rrjetet e të rinjve, këshillet e diasporës (p.sh Këshilli koordinues i shoqatave shqiptare në Austri) me qëllim të krijimit të urave lidhëse mes diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe me qëllim të krijimit dhe forcimit të lidhjeve brenda vetë diasporës. Po ashtu në bashkëpunim me institucione tjera relevante (si ATK, KIESA, DOGANA, MPJ), në diasporë (Austri, Gjermani, Zvicër, Itali etj) ka organizuar sesione informuese për bizneset e diasporës dhe të huaj për mundësitë që Kosova ofron për investime.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale harton politika të punësimit dhe ka rol të rëndësishëm në promovimin e migrimit të rregullt, si dhe në ndërlidhjen e nevojave të tregut të punës me migrimin.

Ministria e Financave gjithashtu angazhohet që përmes politikave fiskale të krijoj klimë të favorshme për investime, duke përfshirë edhe investitorët nga diaspora.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është institucion tjetër i rëndësishëm që ndërlidh migrimin përmes politikave për përmirësimin e ambientit të biznesit siç është promovimi i investimeve dhe eksportit, fuqizimi dhe krijimi i zonave ekonomike, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe forcimi i sektorit privat në përgjithësi.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik gjithashtu në mënyrë indirekte, përmes hartimit të politikave dhe strategjive në sektorin e energjisë, minierave, teknologjisë informative, si dhe në sektorin e ndërmarrjeve publike, synon zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës dhe klimë të përshtatshme zhvillimore për investitorë.

Ministria e Arsimit përmes politikave të saj siguron ruajtjen e identitetit, duke krijuar kurrikula të veçanta për pjesëtarët e diasporës.

7.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 ka qenë e përkushtuar të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes ekonomike si një nga shtyllat esenciale të strategjisë së zgjerimit përmes dialogut të rregullt me BE-në dhe instrumentit të Programit për Reforma Ekonomike. Nën koordinimin e Ministrit të Financave, Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) ²⁷2018-2020, i cili aktualisht është duke u zbatuar, ka të bëjë me reformat e nevojshme për fuqizim të qëndrueshmërisë makroekonomike dhe fiskale, rritjen afatgjate ekonomike dhe konkurrueshmërinë, përfshirë masat mbështetëse të një agjende gjithëpërfshirëse të reformave strukturore lidhur me tregun e energjisë dhe transportit, zhvillimet sektoriale, reformat lidhur me tregtinë dhe mjedisin afarist, ekonominë digjitale, reduktimin e ekonomisë joformale, inovacionin, politikat sociale dhe ato të tregut të punës.

Për të realizuar misionin e saj në mbështetje të diasporës, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike si politikë kryesore strategjike është bazuar në Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018 dhe Planin e Veprimit, në vazhdimësi të kësaj gjatë vitit 2018 ka inicuar procesin e hartimit të Strategjisë së re për Diasporën 2019-2023 dhe Planin e

²⁷ <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,28>

Veprimet 2019-2021. Gjithashtu, diaspora si potencial për zhvillimin ekonomik të vendit është përfshirë edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

Në kuadër të ndërlidhjes së migrimit me aspektin zhvillimor të Republikës së Kosovës, vlen të theksohet se shtyllë kryesore e angazhimit janë aktivitetet e bashkëpunimit me Rrjetin Global të Bizneseve të Diasporës Shqiptare (25 rrjete/degë të themeluara, me mbi 6,000 biznese anëtarë). Po ashtu, janë organizuar konferenca në Republikën e Kosovës me biznese nga Diaspora dhe Kosova, ku kanë marrë pjesë rreth 300 biznese. Po ashtu, janë organizuar dhe mbajtur takime të tjera, me qëllim të informimit të bizneseve nga diaspora për mundësitë që Kosova u ofron për investime. Këto takime, gjithashtu krijuan mundësi bashkëpunimi ndërmjet biznese vendore dhe aty nga diaspora. Nga sesionet informuese si dhe konferenca me biznese nga diaspora, ka rezultuar që rreth 20 kompani kanë iniciuar procedurat për t'u radhitur si investitori strategjik në Kosovë në sektorë të ndryshëm.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të politikave të saj ka zbatuar dy marrëveshje me shtetin gjerman për migrimin qarkor. Qëllimi i marrëveshjeve ka qenë avancimi i shkathtësive profesionale të punëkërkesve përmes sistemit dual (praktikë dhe teori njëkohësisht) të shkollimit. Nga ky program gjatë vitit 2018 kanë përfituar 18 persona. Agjencia e Punësimit përmes divizionit të saj dhe Zyra të Punësimit, vazhdon ofrimin e shërbimeve të migrimit për punësim dhe aftësim profesional, si dhe shfrytëzon modulën informativ në kuadër të uebfaqes së APRK-së për të gjitha shërbimet që ofrohen për migrim të rregullt.

Ministria e Financave, me qëllim të aritjes së një ambienti të favorshëm të të bërit biznes dhe me theks të veçantë krijimi i parakushteve për prodhuesit në mënyrë që të kemi zhvillim të sektorit të prodhimit, ka ndërmarë disa stimulime me qëllim që bizneset prodhuese të zhvillohen sa më shumë dhe këto politika do të ndikojnë në stimulimin e punësimit dhe rrjedhimisht do të ketë një rritje ekonomike më të qëndrueshme.

Vendimi i Qeverisë 13/07, që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2018, liron nga tatimi i akcizës për të gjithë prodhuesit për lëndë të parë, për të gjitha burimet e energjisë të cilat përdoren për qëllime të prodhimit. Po ashtu, Vendimi nr.14/07 liron nga tatimi doganor të gjithë prodhuesit për lëndë të parë dhe gjysmëprodukte që përdoren në proces të prodhimit, për të

gjitha linjat e makinerive prodhuese të cilat përdoren në hapësira prodhuese për prodhim, dhe për pajisjet e teknologjisë së informacionit.

Gjatë vitit 2018 ka pas zhvillime edhe në fushën e lehtësimeve doganore përmes vendimeve si në vijim:

- Vendimi 07/40 Data: 11.04.2017, i cili zbatohet nga janari i vitit 2018 për të gjithë prodhuesit, duke i përjashtuar ata nga pagesa e detyrimeve doganore për një listë të pajisjeve të TI.
- Vendimi 08/40 Data: 11.04.2017, i cili zbatohet nga janari i vitit 2018, për industrinë prodhuese, duke liruar nga pagesa e detyrimeve doganore për pjesë këmbimi të makinerisë së prodhimit të gjithë prodhuesit që janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Komisioni i përbashkët MF, ATK dhe DK, gjatë vitit 2018 ka aprovuar gjithsej 394 vendime/autorizime për subjektet prodhuese. Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, lirimet për subjektet prodhuese për vitin 2018 janë në total rreth 73,8 milion euro. Më në detaje është si vijon: Lirimet nga taksa doganore 9 milion euro, nga Akciza 11.7 milion euro, TVSH-ja 53.1 milion euro.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në kuadër të politikave zhvillimore me qëllim të përmirësimit të klimës së të bërit biznes, ka unifikuar numrin e regjistrimit të bizneseve me Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës dhe ka shkurtuar afatin kohor për regjistrimin e bizneseve në më pak se 2 ditë. Në raportin e Bankës Botërore të të Bërit ²⁸Biznes për vitin 2018, Republika e Kosovës është renditur në vendin e 40-të (në vitin 2017 ishte në vendin e 60-të) nga vendet botërore, pasi që janë zvogëluar taksat për shërbimet e ofruara për bizneset në procesin e regjistrimit të tyre. Ekzistojnë 29 qendra të regjistrimit të bizneseve (one-stop shops) në komunat e Kosovës dhe është zhvilluar moduli për regjistrimin online të bizneseve, ku deri tani kemi mbi 1, 000 biznese online të regjistruara. Në kuadër të MTI-së vepron edhe Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve, mandati i së cilës është të promovojë dhe mbështesë investimet, eksportin, turizmin, NVM-të, dhe Zonat Ekonomike në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë përkujdesjen për bizneset nga Diaspora, të cilat trajtohen njëjtë si investitorët vendorë. Si rezultat i këtyre

²⁸ <https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB2018-Full-Report.pdf>

politikave zhvillimore në vitin 2018 (9,967 biznese) janë regjistruar (Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë) 600 biznese më shumë se në vitin paraprak (9,344 biznese).


Ministria e Zhvillimit Ekonomik në kuadër të politikave zhvillimore, ka hartuar dhe është në zbatim të Strategjisë së Energjisë 2017-2026, e cila përcakton objektiva themelore për zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin eficient të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtëritshme të energjisë, krijimin e tregut konkurrues dhe krijimin e vendeve të reja të punës që ndërlidhen me sektorin e energjisë²⁹. Në sektorin e Teknologjisë Informative ka hartuar Strategjinë e Kosovës për Teknologji Informative e cila është shtytës kryesor për rritje ekonomike, punësim dhe inovacion deri në vitin 2020 përmes rritjes së aftësisë konkurruese ndërkombëtare të industrisë së TI-së.

7.3. Statistikat

Dërgesat e emigrantëve (Remitancat)

Remitancat në përgjithësi kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në R.Kosovës. Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Në vitin 2018, remitancat në R.Kosovës arritën shumën prej 800.6 milionë euro krahasuar me vitin 2017, ku remitancat arritën vlerën 759.2. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2018 kanë pasur pjesëmarrje prej 12% në prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Figura 14: Të hyrat nga remitancat, 2013-2018



²⁹ https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_-_pdf


Burimi: BQK, 2018

Rreth 64% e dërgesave të emigrantëve transferohen përmes sistemit financiar, ndërsa pjesa tjetër përfshin dërgesat e emigrantëve në mallra dhe mjetet e tjera që transferohen përmes kanaleve joformale. Burimet kryesore të dërgesave të emigrantëve vazhdojnë të jenë Gjermania dhe Zvicra, me 31.1% të totalit të dërgesave të pranuar në Kosovë. Italia 4.4% dhe Austria 3.8% të totalit të dërgesave, pasuar nga Belgjika (2.6%), SHBA-të (7%) dhe Suedia (3.4%).

Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte (IHD) në Kosovë në vitin 2018 ishin 272.1 milionë euro ose 6.5% më më të larta krahasuar me vitin paraprak. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur trendi i IHD-ve në Kosovë gjatë periudhës 2013-2018.

Figura 15: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e PBB-së, 2013-2018



Burimi: BQK, 2018


Sektorët në të cilët ka patur trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe kanë ndikuar në rritjen e investimeve gjatë vitit 2018 janë sektorët e patundshmërisë me 76.2% Energjitikës me 9.6%, dhe Ndërtimtarisë me 9.1%.

Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve në Kosovë / Turizmi i Diasporës në Kosovë

Republika e Kosovës gëzon turizëm të konsiderueshëm nga diaspora, veçanërisht gjatë pushimeve sezonale të verës dhe dimrit. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit për qëllime personale janë rritur vazhdimisht që nga viti 2013 siç mund të shihet nga Figura 15, duke

arritur në 1,228.2 euro në vitin 2018, të gjitha në një kohë kur numri i vizitave në Kosovë nga agjencitë ndërkombëtare (përfshirë OJQ-të, misionet e huaja në Kosovë) ka pësuar rënie dhe kjo ka ndikuar në zvogëlimin e shpenzimeve nga këto kategori. Meqë ka pak vizitorë të tjerë në Kosovë, pjesa dominuese e të ardhurave të kësaj kategorie, rreth 90%, mund t'i atribuohet diasporës.


Figura 16: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve, 2013-2018



Burimi: BQK, 2018

Rëndësia e diasporës mund të shihet edhe nga përqindja e pjesëmarrjes në prodhimin e brendshëm bruto ku remitancat përbëjnë rreth 11.3% të PBB-së, shërbimet e udhëtimit të diasporës përbëjnë me 16.4 % dhe IHD-ve në patundshmëri me 2.6%, siç është paraqitur në Tabelën 15. Duke pasur parasysh se shuma e këtyre tre komponentëve përbën më shumë se 30% të prodhimit të brendshëm bruto, të hyrat përkatësisht nga migrimi janë faktor i rëndësishëm për të mundur konsumin e brendshëm të vendit (konsumi plus investimet) dhe për të ndihmuar në ngritje të prodhimit vendor.

Figura 17: Shërbimet e udhëtimit të shprehura në miliona euro, 2013 – 2018



Burimi: BQK, 2018

8. Azili dhe mbrojtja ndërkombëtare

8.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Divizioni për Azil vepron në kuadër të DSHAM-së/MPB, dhe njëherit është organi kryesor përgjegjës për zhvillimin e procedurës së azilit si: shqyrtimin e aplikacioneve për mbrojtje ndërkombëtare, zhvillimin e intervistave, marrjen e vendimeve në shkallë të parë etj;

Qendra për Azil është përgjegjëse për pranimin dhe akomodimin e aplikueseve për mbrojtje gjatë procedurës së përcaktimit të statusit, dhe ka kapacitet për pranimin dhe akomodimin për 100 aplikues, ofrimin e shërbimeve mjekësore, psiko-sociale, këshilla juridike, ofrimin e kurseve të ndryshme të ndërlidhura me integrim, para xhepi etj...

Komisioni Kombëtar për Refugjatë (KKR) është organi kompetent në shkallë të dytë për shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër vendimeve të shkallës së parë. Policia Kufitare e PK-së, është organi përgjegjës në procedurën fillestare, e cila përfshin parashtrimin e aplikacioneve, intervistën fillestare, marrjen e shenjave të gishtërinjve dhe fotografive, dhe transferimin e aplikantëve në Qendrën për Azil.

8.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Politikat e azilit përbëjnë ndër politikat me prioritet për Republikën e Kosovës, në veçanti në kuadër të reformave të ndërmarra në procesin e dialogut të vizave me Bashkimin Evropian, si dhe në zbatimin e masave që rrjedhin nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim me Bashkimin Evropian.

Ligji Nr.04/L-217 për Azil është ndryshuar dhe miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30 mars 2018, është shpallur në Gazetën Zyrtare me 3 maj 2018. Ligji i ri Nr.04/L-217 për Azil transponon pjesërisht aktet e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 2013/33 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 që përcakton standardet për pranimin e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare, dhe
- Direktiva 2013/32 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

Ky ligj rregullon standardet dhe procedurat për dhënien e statusit të refugjatit, mbrojtjes së ndihmës dhe mbrojtjes së përkohshme, si dhe të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve,

refugjatëve dhe personave të cilëve iu është dhënë mbrojtje plotësuese dhe mbrojtje e përkohshme.

8.3. Statistikat


Azilkërkuesit në Kosovë

Numri i azilkërkuesve në Kosovë gjatë vitit 2018 ka qenë 595, duke shënuar rritje për trefish, krahasuar me vitin 2017 (147), ndërsa, në vitin 2016 kanë qenë 307 azilkërkues, dmth. 109% më shumë se në vitin 2017. Mund të thuhet që lëvizjet e migrantëve drejt shteteve perëndimore dhe rrugëtimi i tyre nga vendet e origjinës përmes rrugës ballkanike, vërehet edhe në territorin e Kosovës, sidomos gjatë vitit 2018, gjë që shihet edhe nga statistikat e paraqitura në këtë kapitull.

Nga numri i përgjithshëm i azilkërkuesve sipas gjinisë, gjinia mashkullore prin me 92% (546) kurse gjinia femërore është e përfaqësuar me 8% (49).

Grupmosha më e përfaqësuar është 18-34 vjeç me 74,1%, 35-64 vjeç me 13,9%, 0-13 vjeç me 7,6%, grupmosha 14-17 vjeç me 3,7%, dhe grupmosha 65+ me 4 (0,7%). Vërehet rritje e numrit të azilkërkuesve të grupmoshës 0-13, që tregon trendin e rritjes të familjeve azilkërkuese në Kosovë.

Figura 18: Azilkërkuesit në Kosovë sipas grupmoshës (2016 – 2018)



Burimi: DSHAM/MPB

Numri i konsiderueshëm i azilkërkuesve të grupmoshës 0-13 vjeç, kryesisht të shoqëruar nga familjarët, vjen si pasojë e situatës së përgjithshme në rajon, si dhe të lëvizjeve migruese nga vendet e Lindjes së Mesme. Nga numri i përgjithshëm i kësaj kategorie 2,01% ishin të mitur të pashoqëruar.

Përfaqësimi i lartë i grupmoshës 18-34 vjeç si grupmoshë aktive, mbështetet në faktin se personat në këtë moshë më së shumti iu ishin nënshtruar presionit nga ana e grupeve të ndryshme militare që të marrin pjesë aktive në zonat e luftës në vendet e origjinës, por edhe si rezultat i mundësisë për ta fituar statusin e mbrojtjes apo qëndrimit me qëllime të punësimit në shtetet perëndimore.

Në vitin 2018 ka pasur 550 vendime të shkallës së parë, 310% më shumë krahasuar me vitin 2017 (134). Prej numrit të përgjithshëm të vendimeve, 84,7% (466) të tyre u është ndërprerë procedura, 9,1% (50) vendim pozitiv i përhershëm, 5,1% (28) kanë pasur ndërprerje vullnetare të procedurës, 0,55% (3) refuzim të kërkesës, 0,55% (3) refuzim sipas procedurës së përshpejtuar, kurse 4,7% (28) kanë qenë në fazën e aplikimit, dhe 2,9% (17) në pritje të vendimit në fund të vitit 2018.

Gjatë vitit 2018, vendet kryesore të origjinës së azilkërkuesve në Kosovë janë: Siria 237 (39,8%), Palestina 79 (13,3%), Turqia 75 (12,6%), Algjeria 41 (6,9%), Maroku 36 (6,1%), kurse shtetet e tjera janë të përfaqësuara me 21,2%.

Azilkërkuesve u janë ofruar shërbimet shëndetësore falas, ndihma juridike, administrative, asistencë sociale dhe psikologjike, shujtat ditore, veshmbathja, pakot higjienike dhe format e tjera të ndihmës fizike. Gjithsej 429 persona kanë marrë shërbime mjekësore, 342 shërbime juridike falas, 166 këshilla sociale dhe kurse të gjuhës shqipe dy herë në javë.


Kohëzgjatja e qëndrimit të azilkërkuesve në Qendrën e Azilit gjatë vitit 2018 ka qenë 23 ditë, kurse në vitin 2017 ka qenë mesatarisht 26 ditë.

Azilkërkuesit kosovarë në shtetet anëtarë të BE-së dhe të zonës Schengen

Numri i aplikantëve për herë të parë³⁰ për azil të shtetasve Kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonën Schengen në vitin 2018 ishte 3,395, që në krahasim me numrin e përgjithshëm të aplikantëve ishte për 1,370 (-40.4%) më pak.

Kjo shifër e fundit për vitin 2018 shënoi një rënie prej **2,060 (-60%)** aplikantësh për herë të parë në shtetet e BE-së dhe të zonën Schengen në krahasim me një vit më parë, pasi numri i aplikantëve për herë të parë ra nga **5,455** në 2017 në **3,395** në 2018. Kjo është vazhdimësi nga rënia e konsiderueshme prej **3,955** aplikantësh për herë të parë ndërmjet 2016 dhe 2017. Kjo rënie e konsiderueshme e numrit të azilkërkuesve kosovarë në shtetet e BE-së gjatë vitit 2018 është rezultat i masave parandaluese të ndërmarra nga autoritetet vendore, ngritjes së vetëdijes së qytetarëve kosovarë lidhur me pasojat e migrimit të parregullt, por edhe si rezultat i rritjes së mënyrave të informimit rreth ndryshimit të politikave të azilit dhe migrimit nga vendet e BE-së (shiko Figurën 19).

Figura 19: Azilkërkuesit kosovarë në shtetet e BE-së dhe të zonës Schengen, 2016-2018



Burimi: Eurostat

³⁰ Një aplikant për herë të parë për mbrojtje ndërkombëtare është një person që paraqet një kërkesë për azil për herë të parë në një shtet të caktuar anëtar të BE-së dhe për këtë arsye përjashton aplikantët e përsëritur (në atë Shtet Anëtar) dhe kështu reflekton më saktë numrin e personave të sapoardhur që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në Shtetin Anëtar raportues.

Nga 3,395 aplikantë për herë të parë të regjistruar në vitin 2018, Franca (2,185) përbënte 64% të të gjithë aplikantëve për herë të parë nga R.Kosovës në Shtetet Anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Ky numër u pasua nga Gjermania (565, ose 17%), Belgjika (150, ose 4%), Suedia (150, ose 4%), Zvicër (90, ose 3%) dhe shtetet tjera (260 , ose 8%). Nga numri i përgjithshëm i azilkërkuesve kosovarë, 56,8% janë të gjinisë mashkullore dhe 43,2% të gjinisë femërore.

9. Konkludimet dhe rekomandimet

1. Periudha 2016-2018 karakterizohet me rritje të dukshme të emigrimit të qytetarëve Kosovarë për qëllime punësimi në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, sidomos në vitin 2018. Vendet e destinimit të preferuara janë: Gjermania, Sllovenia dhe Kroacia që rezultojnë me një rritje të dukshme që kanë pranuar qytetarët Kosovarë për qëllime punësimi. Andaj, duke pas parasysh trendin në rritje të emigrimit për qëllime punësimi rekomandohet që: a) të negociohen marrëveshjet bilaterale në fushën e migrimit me vendet e destinimit (aty ky më shumti janë fokusuar emigrantët Kosovarë), përfshirë provizionet e mbrojtjes sociale, kushteve të barabarta pune, qasje në sistemin shëndetësor, etj.
2. Statistikat e viteve të fundit, sidomos 2018 krahasuar me 2016 tregojnë se remitencat, turizmit të diaporës në R.Kosovës si dhe IHD-të (rreth 90% nga diapora) kanë treguar rritje të dukshme dhe përbën rreth 30% të BPV. Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës të krijoj politika dhe programe konkrete që kontribuojnë në orientimin e remitencave dhe kapitalit intelektual për zhvillimin e sektorëve me prioritet të ekonomisë vendore. Njëkohësisht rekomandohet që të krijohen lehtësira në kostot e transfereve të remitencave në bashkëpunim me sektorin financiar.
3. Trendet tregojnë që lëvizjet e ndryshme të lëvizjave migratore në rajon ka filluar të afektoj edhe R.Kosovës, dhe kjo tregon në rritjen e numrit të migrantëve dhe azil-kërkuesve në territorin e Republikës së Kosovës. Rekomandohet që institucionet e Kosovës të krijojnë një mekanizëm monitorimi të trendëve në rajon përmes bashkëpunimit rajonal dhe në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare dhe të zbatoj disa pika nga Plani i Reagimit në rast të fluksit me migrantë dhe refugjatë (si ato që kanë të bëjnë me objekte pritëse apo me pajisje dhe furnizime elementare).